

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Auditimi i avancuar dhe
siguria
(zgjidhjet)**

P10

Data 21 janar 2017

Detyra 1

Ju jeni Beni, menaxher i auditimit në firmën Arlindi & Partnerët, firmë e licencuar e auditimit. Jeni duke lexuar disa shënime nga Arlind Shehu, partneri i angazhimit i caktuar tani në auditimin e GalvaPress Shpk., klienti më i madh i auditimit të firmës.

Shënimi i parë që lexoni është siç vijon:

Beni,

Siç je i informuar, auditimi i ndërmjetëm i GalvaPress për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2015 fillon javën që vjen. Ata janë klientët tanë më të mëdhenj dhe më të rëndësishëm prandaj nuk duam që të bëjmë asnjë gabim as me klientin e as në ndonjë mënyrë tjetër. Fati Cani ka qenë partner i angazhimit për tetë vitet e fundit dhe siç ke dëgjuar tani ai është ndërruar me rrotacion nga ky angazhim. Partnerët tjerë kanë insistuar se ne duhet të dukemi që jemi duke bërë punën si duhet prandaj kemi ndërruar me rrotacion një partner tjetër.

GalvaPress është një gazetë vendore e madhe që publikon një gazetë ditore që shitet në tërë Kosovën. Ata po ashtu shtypin edhe botimin javor të gazetës që aktualisht është gazeta numër tre në treg. Përveç kësaj, ata botojnë edhe revistën javore të lajmeve dhe revistën javore të sportit. Shitjet e të dyjave janë mbajtur mirë.

Kryesisht për shkak të krizës ekonomike kompania është ballafaquar me vështirësi financiare gjatë vitit që përfundoi me 31 dhjetor 2013. Për shkak të kësaj ne kemi përfshirë edhe paragrafin e theksimit të çështjes për 'hipotezën e vijimësisë' në raportin e tyre të auditimit. Mirëpo në nëntor të vitit 2014, ata ishin blerë (100%) nga një miliarder i njohur turk i quajtur Hakan. Ai na ofroi siguri të shkruar në fund auditimit të vitit të kaluar se do të bënte "çkado që duhet" për ta mbajtur kompaninë duke operuar prandaj ne vendosëm që raporti i auditimit të jetë i pamodifikuar.

E kam pasur një takim javën e kaluar me drejtorin ekzekutiv dhe ajo më informoi për çështjet aktuale. Vendimi i tyre më i madh strategjik gjatë vitit ishte të fillojnë me publikimin online "si duhet". Ata e kanë kontraktuar nga jashtë këtë proces nga një entitet në Evropën Juglindore në të cilin valuta funksionale është Dollari Amerikan. Procesi është i thjeshtë, GalvaPress e dërgon gazetën me email në formën "pdf" kësaj kompanie dhe brenda tre orëve kompania e përpunon formatin e gazës që të jetë e lexueshme në lexuesit elektronik, telefona mobil, tablet dhe pajisje të ngjashme.

Kompania e kontraktuar për këto shërbime po ashtu menaxhon edhe të gjitha pagesat e abonimit për gazetën elektronike dhe në fund të çdo muaji i dërgon paratë në GalvaPress (neto pa shpenzimet e kompanisë). Së bashku me këtë pagesë dërgohet edhe raporti se sa gazeta elektronike janë shitur gjatë muajit dhe me çfarë çmimi. Të gjitha pagesat elektronike janë me çmim më Dollar Amerikan dhe gjithashtu pranimet mujore janë në Dollar, por të konvertuara nga banka në Euro në datën e pranimet nga GalvaPress. GalvaPress nuk ka ndonjë llogari bankare në valuta tjera përveç Euro dhe gjithashtu nuk përdorin ndonjë instrument financiar për tu mbrojtur ndaj rrezikut të këmbimit në valuta të huaja.

Konsumatorët e gazetës elektronike mund të blejnë gazetë individuale me çmim pak a shumë të njejtë sikur gazeta e shtypur në Kosovë, por ata mund të përfitojnë nga një zbritje e konsiderueshme nëse regjistrohen/abonohen për periudha prej një muaji deri në tre vite. Kjo pjesë e biznesit është treguar e suksesshme sidomos për personat e Kosovës nga diaspora. Shifrat draft tregojnë se kjo pjesë e biznesit ka shënuar rritje prej 15% për derisa shitja nga gazetë e shtypura ka rënë për 14%.

Kompania e cila është kontraktuar për të ofruar shërbimet e gazetës elektronike nuk lejon që kompanitë të cilave u ofron shërbime të kenë qasje në sistemin e tyre të teknologjisë informative sepse kjo konsiderohet problematike nëse qasen disa kompani që janë duke audituar dhe kryer teste të auditimit. Kjo kompani ka kontratë me një firmë të auditimit 'të profilit të lartë' e cila e kryen auditimin e jashtëm të kompanisë dhe një kopje e këtij raporti i shkon edhe GalvaPress. Auditorët e brendshëm të kompanisë gjithashtu kryejnë auditime të brendshme dhe rezultatet e tyre janë në dispozicion për kompanitë siç është GalvaPress.

GalvaPress është e njohur për gazetari hulumtuese. Ata kanë publikuar artikuj të famshëm në 15 vitet e fundit të ekzistencës së tyre, dhe ngjarja më e famshme ishte skandali financiar i cili kishte rëzuar qeverinë para disa viteve. Kjo gazetë punëson gazetarë të profilit të lartë dhe për deri sa nuk kanë paga të larta ata megjithatë gëzojnë benefite përmes mbulimit bujar të shpenzimeve të ndryshme. Gazeta nuk pyet shumë lidhur me shpenzimet për deri sa këta gazetarë shkruajnë artikuj të mirë dhe qëndrojnë larg padive për shpifje. Drejtori ekzekutiv ishte veçanërisht i shqetësuar se, ne si auditorë, të mos bëjmë shumë pyetje lidhur me shpenzimet e gazetarëve, sidomos lidhur me katër gazetarët kryesor të cilët e kishin bërë të qartë se arsyeja kryesore pse punojnë për GalvaPress është për "lirinë" që ia ofron gazeta.

Kërkohet:

Përgatitni një raport në të cilin:

- (a) Vlerësoni çështjet e kontrollit që dalin nga fakti se GalvaPress nuk ka qasje te kontraktori tek i cili ka kontraktuar publikimin dhe procesimin e gazetës elektronike. (11 pikë)
- (c) Vlerësoni rrezikun e biznesit dhe rreziqet përkatëse të anomalisë materiale që dalin nga çështjet e diskutuara në skenar më sipër. (11 pikë)
- (c) Vlerësoni vendimin të mos përfshihet referenca e 'hipotezës së vijimësisë' në raportin e auditimit të vitit që përfundoi me 31 dhjetor 2014 dhe konsideroni pasojat që kjo mund të ketë në auditimin e planifikuar të këtij viti. (8 pikë)

Total: 30 pikë

Zgjidhja

(a) Vlerësimi i çështjeve të kontrollit lidhur me procesimin dhe publikimin e gazetës elektronike

Drejtorët e GalvaPress janë përgjegjës ëpr mjedisin e kontrollit. Duke marrë parasysh se të hyrat nga ky burim tani janë 15% të të hyrave totale, operacionet e teknologjisë informative të kryera nga kompania e kontraktuar janë një aspekt i rëndësishëm i sistemit të kontrollit të brendshëm të GalvaPress. Çfardo gabimi që mund të ndodhë aty mund të çoj në të hyra të pasakta të pranuar nga kjo kompani lidhur me shitjen e gazetave elektronike.

Fakti që GalvaPress nuk ka qasje të drejtpërdrejt në kompaninë e kontraktuar do të thotë se nuk ka ndonjë mënyrë praktike për të kontrolluar nëse informatat e ofruara janë të sakta. Gjithashtu kompania e kontraktuar do të grumbullojë të dhëna personale të konsumatorëve të cilat mund të komprometohen nëse siguria e të dhënave është e dobët

Këta konsumatorë mund ta mbajnë GalvaPress përgjegjëse nëse ka rrjedhje të informatave psh vjedhje të detajeve të kartave të kreditit. Auditorët e Galvapress do të kërkojnë nëse kompania ka aftësinë të mbajë nën kontroll çështjet kontabël që lidhen me shitjet e gazetës elektronike dhe nëse kompania e kontraktuar ka kontrole të brendshme të mjaftueshme që të sigurojë se të dhënat e procesuara janë të plota dhe të besueshme.

Si auditorë duhet të sigurohemi se ekzistojnë marrëveshje të duhura me kontraktorin për të procesuar si duhet, raportuar dhe mirëmbajtur të dhënat e konsumatorëve dhe se sistemet e kontrollit janë efektive për të parandaluar dhe zbuluar çfardo anomalie.

(b) Rreziqe e biznesit

Rreziku i biznesit	Rreziku i anomalisë materiale
Rreziku i regjistrimit të gabuar të arkëtimeve nga shitja e gazetave elektronike; ndjeshmëria ndaj mashtrimit; mungesa e informatave të besueshme për vendimmarrje.	Të hyrat dhe të hyrat e shtyra mund të përmbajnë anomali materiale
Ndarje jo e duhur në mes të arkëtimeve nga shitja e gazetave individuale me ato të parapaguara për një periudhë më të gjatë.	Anomali në kategorizimin e të hyrave dhe të hyrave të shtyra
Keqpërdorimi i pasurisë së GalvaPress nga ana e gazetarëve. Mundësi e ngarkesës jo të duhur të shpenzimeve. Mosnjohja e përfitimeve të gazetarëve si të ardhura bruto	Regjistrimi i shpenzimeve jo-biznesore si shpenzime biznesore është klasifikim i gabuar i shpenzimeve që ndikon në nënvlerësim të detyrimit për paga të pagueshme dhe nënvlerësim të tatimit në të ardhura të korporatave.
Ndryshimet teknologjike në përgatitjen e gazetës elektronike	Kjo mund të mos konsiderohet si rrezik i anomalisë materiale përveç nëse kompania ka investuar shuma materiale në teknologji e cila mund të ketë nevojë të testohet për dëmtim.
Ka gjithmonë rrezik nga veprimet ligjore që dikush mund ti ngre për shpifje kundër kompanisë.	Rreziku i plotësisë së detyrimeve ose nevojës për provizionim lidhur me shpenzimet ligjore.

(d) Auditorët duhet të konsiderojnë nëse kanë mbështetje të duhur nga evidencat e auditimit nëse vendosin se është e nevojshme t'i referohen hipotezës së vijimësisë në raportin e auditimit.

Një mbështetje e tillë është edhe 'letra e mbështetjes'. Këto letra zakonisht ofrohen nga kompania mëmë lidhur me degën e saj. Në këtë rast kjo siguri ose mbështetje ka ardhur nga pronari përfundimtar.

Janë dy çështje të rëndësishme që duhet të konsiderohen nga auditori në këtë situatë.

1. A është ky premtim i dhënë në atë mënyrë sa që përbën obligim ligjor për të mbështetur kompaninë? Nëse auditorët janë të sigurt se është një gjë e tillë, ata mund ta pranojnë si dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme.

2. A është vetë enteti që premtim mbështetjen i aftë të ofrojë këtë mbështetje? Kompania mëmë mund të jetë e gatshme të merr përsipër borxhet e degës por ndoshta vetëm deri në një masë të caktuar.

Nëse edhe në këtë rast auditori sigurohet se mbështetësi ka fonde të mjaftueshme, atëherë mund të vijë në përfundim se nuk ka nevojë të përfshihet paragrafi i theksimit të çështjes për hipotezën e vijimësisë.

Në këtë rast të caktuar, nuk është e mundur të thuhet nëse firma e auditimit është e sigurt se mbështetja është e duhur. Mirëpo, ka një kompditet pasi që letra është në formë të shkruar direkt nga pronari dhe ai vet do të humb shumë nëse nuk e përmbush premtimin, natyrisht duke supozuar se ky premtim paraqet obligim ligjor për pronarin.

Nëse pronari me të vërtetë është një 'miliarder' do të dukej se fondet nuk përbëjnë çështje problematike. Mirëpo auditori së paku duhet të kontrollojë nëse kjo është e vërtetë. Kjo çështje mund të jetë sensitive pasi që kërkohet të kontrollohen financat personale të personit dhe për këtë do të duhet një miratim nga ai.

Si përmbledhje, vendimi për të mos përfshirë referencën e hipotezës së vijimësisë në raport duhet të mbështetet me evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit.

Pasojat për auditimin aktual të GalvaPress është se kompania ka ca vështirësi financiare prandaj procedurat e auditimit lidhur me vijimësinë duhet të përsëriten edhe këtë vit në mënyrë që auditori të sigurohet se nuk ka ndonjë pasiguri materiale lidhur me aftësinë e kompanisë për të vijuar operacionet.

Detyra 2

Jeni në fazën e fundit të auditimit të Hera Shpk për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2016. Jeni duke biseduar me drejtorin financiar (kontabilist i certifikuar) i cili ju thotë se beson që nuk ka nevojë të ekzaminoni librin e blerjes për vitin 2016 dhe të testoni të dhënat mbështetëse për regjistrimet në kontabilitet për 2016. Ai më tutje deklaron se:

- (i) Faturat që janë pranuar shumë vonë për tu regjistruar në dhjetor 2016 janë regjistruar pëmes një regjistrimi direkt në ditar në fund të vitit; dhe
- (ii) Auditori i brendshëm kishte testuar këtë proces në fund të vitit; dhe
- (iii) Ai (drejtori financiar) do të ju ofroj një letër që certifikon se nuk ka ndonjë detyrim të paregjistruar me 31 dhjetor 2016.

Kërkohe:

(a) Kërkimi i detyrimeve të paregjistruara shpesh është pjesa më e vështirë e auditimit për të grumbulluar dëshmi përfundimtare ose gjithpërfshirëse. Prandaj, sa i përket detyrimeve thuhet se plotësia është njëri nga pohimet më me rrezik.

Diskutoni se deri në çfarë mase deklarata e mësipërme (a), konsiderohet se është bërë edhe më e përshtatshme dhe e rëndësishme në kohën e krizës ekonomike.

(4 pikë)

(b) Vlerësoni deri në çfarë mase testet e auditorit lidhur me detyrimet e paregjistruara të Hera Shpk duhet të ndikohen nga fakti se klienti ka bërë vetëm një regjistrim në ditar për të regjistruar faturat e 2016 që janë pranuar vonë.

(4 pikë)

(c) Diskutoni deri në çfarë mase testet e auditorit lidhur me detyrimet e paregjistruara të Hera Shpk duhet të ndikohen nga fakti se është pranuar një letër në të cilën zyrtari përgjegjës certifikon, sipas njohurisë së tij më të mirë, se janë regjistruar të gjitha detyrimet.

(3 pikë)

(d) A duhet të eliminohen ose zvogëlohen testet nga auditori i jashtëm për detyrimet e paregjistruara në Hera Shpk për faktin se këto teste janë kryer nga auditori i brendshëm? Shpjegoni.

(4 pikë)

(e) Hera Shpk tash së voni i është nënshtruar një kontrolli nga Adminsitrate Tatimore. Diskutoni deri në çfarë mase mund të mbështeteni në rezultatet e këtij kontrolli sa i përket sigurisë për detyrimet e paregjistruara në fushën e tatimit në të ardhura të korporatave, TVSH, tatimi në paga dhe kontribute pensionale si dhe gjoba dhe interes.

(5 pikë)

(f) Çfarë burime tjera, përveç librit të blerjes së vitit 2016, duhet të konsideroj auditori për të zbuluar detyrimet e mundshme të paregjistruara?

(5 pikë)

Total: 25 Pikë

Zgjidhja

(a) Përcaktimi i plotësisë së detyrimeve është dhe ka qenë njëra ndër aspektet më të vështira të auditimit. Kjo për faktin se përfshinë vërtetimin të kundërtën, do të thotë se nuk ka detyrime tjera që nuk janë përfshirë në pasqyrat financiare.

Detyrimet janë më të vështira për tu audituar sepse:

- a. Detyrimet janë gjithmonë të paprekshme
- b. Detyrimet mund të ndodhin edhe pa veprimin e organizatës
- c. Mund të ekzistojnë detyrime jashtë sistemit normal të kontabilitetit.

Përveç kësaj, në këto kohëra të vështira financiare, organizatat mund të kenë tendenca të fshehin ekzistencën e detyrimeve.

Në anën tjetër mund të ketë detyrime ndaj ishtitucioneve financiare të cilat mund të aplikojnë kushte të tilla të financimit siç janë marrje me lizing dhe shitje, kredi të ndryshme etj të cilat ndonjëherë paraqesin rrezik të ndodhjes së detyrimeve shtesë ose klasifikimit të gabuar të detyrimeve. Është fakt se është vështirë të gjykohet mjaftueshmëria dhe përshtatshmëria e evidencave të auditimit lidhur me detyrimet. Auditorët duhet të jenë në dijeni për treguesit të ekzistencës së detyrimeve dhe faktit se klientët mund të përpiqen të fshehin ato.

(b) Fakti që klienti ka regjistruar direkt në ditar të gjitha faturat e furnitorëve do të thjeshtonte testimin e auditorëve për detyrimet e paregjistruara dhe do të zvogëlonte nevojën për korrigjime shtesë, por megjithatë testimi nga auditori është i domosdoshëm. Nga klientët pritet që të përfshijnë të gjitha korrigjimet në fund të vitit dhe në këtë rast nëse klienti ka përfshirë të gjitha detyrimet në vitin të cilin i takojnë atëherë kjo nuk përbën problem. Auditori duhet të testojë faturat e pranuar me vonësë së i takojnë periudhës kontabël për të cilën kryhet auditimi dhe nuk janë të periudhës së ardhshme.

(c) Përfaqsimet e shkruara në përgjithësi nuk përbëjnë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme nëse nuk janë mbështetur me dëshmit tjera vërtetuese. Nga auditori kërkohet të marr një letër të përfaqësimit në të cilën menaxhmenti merr përgjegjësinë për plotësinë e informacioneve në pasqyrat financiare, megjithatë kjo nuk e shkarkon nga përgjegjësia për të kryer testet e nevojshme të auditimit, që në rastin tonë janë teste të plotësisë së detyrimeve.

(d) Nëse auditori vendos të mbështetet në punën e auditorëve të brendshëm në pajtueshmëri me SNA 610 atëherë duhet të përcaktojë auditorët e brendshëm kanë kualifikimin teknik dhe pavarësinë e duhur. Pasi që auditori të sigurohet në këto pika të rëndësishme, auditori duhet të diskutojë natyrën dhe fushëveprimin e programit të auditimit të brendshëm për të përcaktuar nëse testet e auditimit janë në pajtueshmëri me programin e auditimit të jashtëm. Nëse auditori vendos të mbështetet në punën e auditorit të brendshëm, auditori i jashtëm mund të kufizoj punën e tij të auditimit.

(e) Është detyrë e auditorit të përcaktojë nëse detyrimet në fund të periudhës nuk përmbajnë anomali materiale. Kjo përfshin gjithashtu edhe detyrimet për tatime, TVSH, contribute pensione etj.

Fakti që klienti i është nënshkruar një kontrolli tatimor nga administrata tatimore mund të ju ofroj juve si auditor evidence shtesë lidhur me detyrimet e paregjistruara. Mirëpo auditori nuk mund të mbështetet në tërësi në kontrollin nga administrata tatimore për të zbuluar të gjitha detyrimet për të cilat ne si auditor mund të kemi njohuri nga testet tjera.

Një gjë e mirë nga kontrolli tatimor është përcaktimi i shumave, nëse ka, për interesin dhe gjobat e pagueshme të cilat administrata tatimore i ngarkon entitetit. Po ashtu pas kontrolleve tatimore mund të ketë marrëveshje me administratën tatimore lidhur me shlyerjen e borxheve të cilat mund të jenë të ndryshme nga llogaritjet e auditorit, prandaj raportet e kontrollit mund të jenë të dobishme në këtë aspekt.

(f) Përveç librit të blerjes, auditor mund të konsideroj edhe burimet tjera për të zbuluar detyrimet e paregjistruara.

1. Nëse ekziston një libër i veçantë i pagesave, të ekzaminohen dokumentet përkatëse gjatë periudhës fillestare të vitit të ardhshëm për të përcaktuar nëse pagesat kanë të bëjnë me detyrimet e vitit aktual.
2. Faturat e furnitorëve që nuk janë regjistrua në librin e blerjeve.
3. Statusi i deklaratave tatimore për vitet e mëparshme
4. Diskutimi me të punësuarit
5. Përfaqësimet nga menaxhmenti
6. Krahasimi i saldove të llogarive me vitin e mapërshëm
7. Ekzaminimi i llogarive individuale
8. Kontratat dhe marrëveshjet ekzistuese
9. Procesverbalet e takimeve të bordit
10. Korrespondencat me përfaqësuesit ligjor
11. Korrespondencat me furnitorët kryesor
12. Testimi i prerjes për llogaritë reciproke, psh stoqet me pasuritë joqarkulluese

Detyra 3

(a) Udhëzimet për ngjarjet pasuese janë dhënë në SNA 560 (i rishikuar) Ngjarjet Pasuese.

Kërkohet:

Shpjegoni përgjegjësinë e auditorit lidhur me ngjarjet pasuese.

(5 pikë)

(b) Heri është një kompani automobilistike e listuar në bursë. Pasqyrat financiare draft për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2016 paraqesin fitim para tatimit prej €5.4 milion dhe pasuri totale prej €20.8 milion. Ju jeni meanxher i auditimit dhe seniori ju ka ofruar informatat në vijim:

(i) Gajtë vitit që përfundon me 31 dhjetor 2016 Heri ka shpenzuar €800,000 në hulumtimin e një motori efikas me djegie të brendshme. Si rezultat i këtij hulumtimi, Heri ka disenjuar një motor të ri dhe ka bërë një progres domethënës në zhvillimin e këtij motori. Gjatë vitit që përfundon me 31 dhjetor 2016 janë shpenzuar € 1.5 milion në këtë projekt ('Shtytja e re'). Drejtorët e Heri kanë kapitalizuar kosotn prej €1.5 milion si pasuri të patrupëzuar.

(8 pikë)

(ii) Me 30 nëntor 2015 Heri pranoi një lajmërim nga juristi i tyre lidhur me një pretendim ligjor nga konsumatorët për problemin që kishin pasur me sistemin e frenimit në automjetet e prodhuara nga Heri. Me 31 dhjetor 2015 nuk ishte e ditur as mundësia e ndodhjes së këtij pretendimi e as shuma nuk mund të përcaktohej dhe si rezultat i kësaj nuk ishte njohur ndonjë provision në pasqyrat financiare për vitin që përfundoi me 31 dhejtor 2015. Me 31 dhjetor 2016 rasti është ende në proces por tani juristi i kompanisë ka këshilluar Heri se shuma e pretendimit është vlerësuar në €2 milion dhe që pretenduesit kanë shumë mundësi të kenë sukses në gjykatë.

(7 pikë)

(iii) Gajtë vitit është përcaktuar një skemë e opsioneve të aksioneve. Sipas skemës, të gjithë drejtorëve u janë dhënë opsione me 31 korrik 2016. Opsionet do të maturohen me 31 korrik 2019 me kusht që drejtorët të jenë ende të punësuar me atë datë.

(5 pikë)

Kërkohet:

Për secilën nga pikat e mësipërme:

- (i) Komentoni mbi çështjet që duhet të konsiderohen
- (ii) Shpjegoni testet e auditimit të cilat duhet të kryhen para takimit tuaj me partnerin e auditimit javën që vjen.

Shënim. Supozoni se është data 11 shkurt 2017.

Total: 25 pikë

Zgjidhja

Ngjarjet pasuese definone si ngjarje që ndodhin në mes të datës së pasqyrave financiare dhe datës së raportit të auditimit, dhe po ashtu faktet që janë zbuluar pas datës së raportit të auditimit.

SNA 560 *Ngjarjet pasuese* bëjnë dallimin në mes të përgjegjëseve të auditorit lidhur me ngjarjet pasuese varësisht nga koha kur ndodhë një ngjarje pasuese.

Ngjarjet që ndodhin deri në datën e raportit të auditorit.

Auditori ka detyrë aktive për të kryer procedura të dizajnuara për të identifikuar dhe përfutur dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të gjitha ngjarjet deri në datën e raportit të auditorit të cilat ngjarje mund të kërkojnë korrigjim ose shpalesje në PF. Këto procedura duhet të kryhen sa më afër të jetë e mundshme datës së raportit të auditorit, dhe përveç kësaj duhet të kërkojnë përfaqësim nga menaxhmenti.

Procedurat mund të përfshijnë rishikimin e procedurave të menaxhmentit për të siguruar se ngjarjet pasuese janë identifikuar, leximi i procesverbaleve të takimeve të bordit, rishikimi i pasqyrave financiare të ndërmjetme, bisedat e duhura menaxhmentin.

Kur një ngjarje material pasuese është zbuluar, auditorit duhet të konsiderojë nëse menaxhmenti ka trajtuar si duhet dhe shpalesur si duhet në PF në pajtueshmëri me SNK 10 *Ngjarjet pas datës së raportimit*.

Faktet e zbuluara pas datës së raportit të auditorit por para datës së publikimit të PF.

Auditori nuk ka ndonjë përgjegjësi të kryej procedura ose ti parashtrijë pyetje menaxhmentit sa i përket pasqyrave financiare ose ngjarjeve pasuese pas datës së raportit të auditimit. Në këtë periudhë, është përgjegjësi e menaxhmentit të informojë auditorin për faktet të cilat mund të ndikojnë në PF.

Kur auditori është në dijeni për faktet të cilat mund të ndikojnë materialisht PF, çështja duhet të diskutohet me menaxhmentin. Nëse PF janë ndryshura në mënyrë të duhur, atëherë duhet të jepet një opinion i ri i auditimit, dhe procedurat që kanë të bëjnë me ngjarjet pasuese duhet të shtrihen deri në datën e raportit të ri. Nëse menaxhmenti nuk i ndryshon PF për të reflektuar ngjarjen pasuese, në rrethana kur auditori beson se duhet të ndryshohet, duhet të jepet opinion me rezervë ose i kundërt.

Faktet e zbuluara pasi që pasqyrat financiare janë publikuar.

Pas publikimi të pasqyrave financiare, auditori nuk ka obligim të parashtrijë pyetje lidhur me PF. Mirëpo, nëse auditori është në dijeni për ndonjë fakt që ka ekzistuar në datën e raportit të auditimit, që po të dihej në atë kohë do të shkaktonte modifikimin e raportit të auditorit. Në këtë rast, çështja duhet të diskutohet me menaxhmentin. Kjo mund të rezultojë me korrigjim të pasqyrave financiare, dhe në këtë rast auditori do të lëshonte raport të ri të auditimit për PF të korrigjuara. Ky raport do të përfshijë një paragraf të theksimit të çështjes që i referohet shënimit në PF në të cilin paraqiten arsyet e korrigjimit të PF. Nëse menaxhmenti refuzon të korrigjoj PF, auditori duhet të marrë këshilla ligjore me qëllim të përpjekjes për të parandaluar mbështetjen e mëtutjeshme të shfrytëzuesve të PF në raportin e auditimit.

(a) **Projekti Shtytja e Re**

(i) *Çështjet që duhet konsideruar*

- Nëse shpenzimet e ndodhura në projektin **Shtytja e Re** përmbushin kriteret siç specifikohen në SNK 38 për projektin që të kapitalizohet si kosto e zhvillimit
- Nëse shpenzimet e ndodhura janë €1.5 milion
- Nëse drejtorët kanë bërë shpalesjet e duhura në pajtueshmëri me SNK 38
- Kur do të hyjë në përdorim motori (dmth, a është edhe kjo kosto e zhvillimit)
- Cilat janë të hyrat e parashikuara nga motori
- Për çfarë periudhe do të jetë motori në treg

(ii) *Testet e auditimit*

- Përftoni detaje se si Heri i ka alokuar kostot në projekte individuale
- Rishikoni sistemin e alokimit të kostove në projekte
- Kontrolloni se ka kontrole të mjaftueshme për të siguruar se vetëm kostot e identifikueshme janë alokuar në secilin projekt
- Përftoni një analizë të €1.5 milion dhe kontrolloni se kostot kanë të bëjnë me projektin
- Ndjekni materialet deri te faturat
- Ndjekni koston e punës deri tek lista e pagave
- Vërtetoni se si drejtorët alokojnë shpenzimet e përgjithshme dhe rishikoni metodën për arsyeshmëri
- Përftoni detaje të projektit dhe vërtetoni se është projekt qartë i identifikueshëm
- Përftoni detaje të rezultateve të provave deri me këtë datë dhe diskutoni me menaxherin e projektit për të konfirmuar arsyeshmërinë teknike të projektit
- Përftoni detaje të hulumtimit të tregut për të siguruar se projekti është i vlefshëm nga aspekti komercial
- Përftoni parashikimet për parane dhe vlerësoni supozimet për të testuar arsyeshmërinë nëse të hyrat e parasë në të ardhmen do të tejkalojnë kostot deri me tani dhe kostot e ardhshme të marketingut
- Rishikoni parashikimet e shitjeve dhe përputhini me hulumtimet e tregut për të konfirmuar arsyeshmërinë
- Rishikoni nivelin e financimit të kërkuar për të përfunduar projektin dhe diskutoni me drejtorët se si ata kanë për qëllim të përmbushin nevojat për financim
- Rishikoni procesverbalet e takimeve të bordit për detajet ose diskutimet për progresin e projektit
- Përftoni përfaqësime të shkruara nga menaxhmenti lidhur me vlefshmërinë komerciale, arsyeshmërinë teknike dhe mjaftueshmërinë e financimit të projektit
- Konfirmoni me menaxhmentin se ata do të përmbushin kërkesat për shpalosje sipas SNK 38
- Rishikoni progresin e projektit në periudhën pas përfundimit të vitit dhe rishikoni detajet e ndonjë produkti të ngjashëm nga konkurrenca

(b) **Çështja ligjore**

(i) *Çështjet që duhet konsideruar*

- Nëse drejtorët kanë për qëllim të bëjnë ndonjë provision në PF për vitin që përfundon me 31 dhjetor
- Nëse është i mjaftueshëm provizioni prej €2.0 milion
- Bazën e llogaritjes së €2.0 milion
- Datën e mundshme të zgjidhjes
- Nëse duhet të shplaosen në mënyrë të veçantë €2 milion në pajtueshmëri me SNK 1 në PF.
- Nëse drejtorët do të bëjnë shpalosje të mjaftueshme në PF

(ii) *Testet e auditimit*

- Përftoni detaje të punës së kryer të auditimit për vitin që përfundon me 31 dhjetor
- Përftimi i kopjeve të korrespondencave nga këshilltari ligjor lidhur me testet/provat dhe rishikimin e detajeve të mundësisë së ndodhjes si dhe llogaritjen e €2 milion.

- Diskutoni me drejtorët për reagimin e tyre lidhur me vlerësimin nga këshilltari ligjor
- Merrni leje nga drejtorët për të kontaktuar këshilltarin ligjor
- Kontaktoni këshilltarin ligjor dhe pyetni për konfirmimin e vlerësimit të tyre për ndodhjen dhe vlerën
- Rillogaritni llogaritjen e €2 milion
- Rishikoni periudhën e pas fundit të vitit për korrespondenca të mëtutjeshme lidhur me pretendimin
- Rishikoni periudhën e pas fundit të vitit për pagesa me para për tu siguruar nëse është bërë ndonjë zgjidhje e rastit jashtë gjykatës dhe krahasoni me shumat e paraqitura
- Rishikoni procesverbalet e takimeve të bordit për diskutimet e drejtorëve lidhur me pretendimin
- Diskutoni me menaxhmentin nëse ata kanë për qëllim të nohin ndonjë provision në PF e vitit
- Vërtetoni natyrën e shpalesjes që do ta bëjë menaxhmenti
- Konfirmoni se shpalesjet i përmbushin kërkesat e SNK 37 dhe SNK 1
- Diskutoni me menaxhmentin nëse ka ndonjë implikim për produktet e prodhura nga Heri
- Bëni rishikimin e periudhës pas fundit të vitit për të rishikuar të gjitha korrespondencat me këshilltarin ligjor për të verifikuar nëse a pasur pretendime tjera lidhur me produktet tjera

(c) **Skema e opsioneve të aksioneve**

(i) *Çështjet që duhet të konsiderohen*

- Nëse drejtorët kanë njohur shpenzimin për skemën në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse
- Kushtet e skemës, siç është numri i opsioneve që do të japin
- Nëse vlera e opsioneve është llogaritur duke përdorur metodën në pajtueshmëri me IFRS 2 *Pagesat e bazuara në aksione*
- Nëse janë azhurnuar supozimet për numrin e drejtorëve që do të kenë të drejtë të marrin opsionet
- Nëse detajet e skemës janë shpalosur si duhet në PF

(ii) *Testet e auditimit*

- Inspektioni dokumentimin e skemës për të verifikuar kushtet, numrin e opsioneve të ofruara, datat e ofrimit dhe datat e dhënies dhe kushtet e tyre
- Përftoni llogaritjet e vlerës së drejtë të opsioneve dhe përputhni përbërësit e llogaritjes, siç është vlera e drejtë e aksioneve me informatat e publikuara nga tregjet financiare.
- Rillogaritni shpenzimet e vitit actual, për të siguruar se vetëm shpenzimet e 6 muajve janë njohur
- Rishikoni regjistrimet në ditar për shpenzimin e opsioneve të aksioneve dhe kontrolloni se janë kredituar në ekuitet e jo në detyrime pasi që kjo është pagesë që bëhet përmes ekuitetit

Detyra 4

(a) SNA 706 (E rishikuar), *Paragrafët e theksimit të çështjes dhe paragrafët e çështjes tjetër në një raport të auditorit të pavarur* ofron udhëzime për përdorimin e këtyre paragrafëve nga auditorët.

Reuired:

(i) Përkufizoni një 'Paragraf të theksimit të çështjes' dhe shpjegoni me shembuj përdorimin e këtij paragrafi. (6 pikë)

(b) Ju jeni menaxher përgjegjës për auditimin e Lejla Shpk, një kompani prodhuese për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2016. Puna e auditimit ka përfunduar dhe është rishikuar dhe jeni gati të lëshoni raportin e auditimit brenda tre ditësh. Opinion draft i auditimit është i pamodifikuar. Pasqyrat financiare paraqesin të hyra prej €15 milion, fitim neto prej €3 milion dhe pasuri prej €80 milion me 31 dhjetor 2016.

Drejtori financiar i Lejla Shpk ju telefonoj në mëngjes për të ju treguar për lajmërimin e djeshëm lidhur me një ristrukturim domethënës të Lejla që do të ndodh në gjashtë muajt e ardhshëm. Ristrukturimi do të përfshijë mbylljen e fabrikës dhe rilokimin në një pjesë tjetër të shtetit. Do të ketë disa teprica në punëtorë dhe kosto e vlerësuar e mbylljes do të jetë €250,000. Pasqyrat financiare nuk janë ndryshuar për të reflektuar këtë çështje.

Kërkohet:

Lidhur me lajmërimin për ristrukturim:

(i) Komentoni mbi implikimet në raportimin financiar dhe këshilloni për procedurat e mëtutjeshme të auditimit që duhet të kryhen; dhe (7 pikë)

(ii) Rekomnadori për veprimet që do të merren nga auditorët nëse pasqyrat financiare nuk korrigjohen. (7 pikë)

Total: 20 pikë

Zgjidhja

(a) (i) Paragrafi i theksimit të çështjet është paragraf i cili përfshihet në raportin e auditorit dhe që referohet një çështjeje që është shpalosur si duhet në PF, që sipas gjykimit të auditorit është me aq rëndësi sa është fundamentale për shfrytëzuesit të kuptojnë PF. SNA 706 Paragrafi i theksimit të çështjes dhe paragrafet e çështjeve tjera, tregon se paragrafi duhet të përdoret vetëm nëse auditori ka dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme që çështja nuk është anomaly materiale për PF. Një paragraf i tillë duhet t'ireferohet vetë informatave të prezantuara ose shpalosura në PF.

Paragrafi prandaj përdoret për të nënvizuar çështje fundamentale për shfrytëzuesit e PF. Nuk ka të bëjë me mosmarrëveshjen ose kufizimin e fushëveprimit dhe prandaj nuk është kualifikim i opinionit të auditorit. Paragrafi i theksimit të çështjes duhet qartë të theksoj se opinionin e auditorit nuk është modifikuar sa i përket çështjes së theksuar.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet të përfshijë referencë të qartë të çështjes e cila theksohet dhe referencë shpalosjes përkatëse në PF.

Shembuj janë ofruar në SNA 706 për situatat potenciale në të cilat përdoret paragrafi i theksimit të çështjes:

- Çfardo pasigurie lidhur me rezultatet e ardhshme të rasteve gjyqësore ose veprimeve rregullatore
- Aplikimi i hershëm i ndonjë standardi të kontabilitetit (në rast se lejohet) dhe që ka efekt të madh në PF.
- një katastrofë e madhe që ka pasur dhe vazhdon të ketë efekt domethënës në pozitën financiare të entitetit..
- Çështje domethënëse për vijimësinë e kompanisë.

(b) (i) Shpallja për ristrukturimin pas datës së raportimit është një ngjarje që nuk kërkon korigjim, sipas SNK 10 *Ngjarjet pas periudhës së raportimit*. Kjo është për shkak se ngjarja nuk ka ofruar dëshmi lidhur me kushtet që kanë ekzistuar para fundit të vitit.

Llogaritja e materialitetit sa i përket kostos potenciale të mbylljes është siç vijon:

Bazuara në të hyra: €250,000/15 milion = 1.67%

Bazuara në të hyra: €250,000/3 milion = 8.33%

Bazuara në të hyra: €250,000/80 milion = <1%

Prandaj kjo shumë është material për pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Sipas SNK 10, duhet të përfshihet një shënim sqarues në PF, i cili përshkruan natyrën e ngjarjes dhe ofron një parashikim të efektit financiar.

Procedurat e auditimit mund të përfshijnë:

- Rishikimi i shënimit sqarues në PF i cili duhet të shpalosë ngjarjen që nuk kërkon korigjim, duke ofruar përshkrimin e ngjarjes dhe vlerësimin për efektin financiar.
- Diskutimi i arsyeve për ristrukturimin me anëtarët kyç të menaxhmentit, leximi i procesverbaleve të takimeve, për të fituar kuptim lidhur me arsyen e ristrukturimit.
- Verifikimi i aprovimit të vetë planit, dhe aprovimi i shpalljes së planit, i cili mund të bëhet përmes rishikimi të proceverbaleve të takimeve.
- Konfirmimi i datës në të cilën është aprovuar plani, si dhe datën e shpalljes, duke përdorur dokumente mbështetëse siç janë informimet për shtyp, letrat dërguar të punësuarve, takimet e brendshme me punonjësit, etj.
- Marrja e kopjes së shpalljes dhe rishikimi i detajeve, në veçanti përshkrimi i naturës së saktë të ristrukturimi, përfshirë, numrin e të punësuarve që janë ndikuar nga ristrukturimi.

- Barazimi i €250,000 të kostos të mundshme të mbylljes me dokumentet mbështetëse, përfshirë tabelën në të cilën tregohet numri dhe grada e stafit të tepërt, i cili do të mbështetej me detaje të regjistrimit të pagave dhe kontratave.
- Përdorimi i rezultateve për diskutim me menaxhmentin, vlerësimi i ristrukturimit të planifikuar në kontekst të njohurisë së auditorit për biznesin, duke konsideruar nëse ka mundësi të ndodhin kosto të tilla.

(ii) Veprimet për tu ndërmarrë nga auditori:

Nëse nuk është ofruar ndonjë shënim në PF, atëherë ka shelje të SNK 10. Në këtë rast ka shpalosje të pamjaftueshme në pasqyrat financiare sa i përket ngjarjes pasa datës së raportimit.

Në pajtueshmëri me SNA Modifikimet e Raportit të Auditorit të Pavarur, në rastet kur auditori nuk pajtohet me menaxhmentin lidhur me zbatimin e ndonjë standardi të raportimit financiar dhe kur ky mospajtim është material për PF, auditori duhet të shprehë një opinion me rezervë ose opinion të kundërt. Këtu, çështja është material por nuk është përhapëse, prandaj opinion i përshtatshëm është opinion me rezervë me 'përveç për'. Raporti i auditimit përmbanë paragraph i cili shpjegon arsyen për rezervim, duke specifikuar shkeljen e standardit të kontabilitetit dhe duke theksuar shumat relevante financiare. Po ashtu do të ishte praktikë e mirë për auditorin të qartësojë se fitimi për vitin nuk është ndikuar nga shkelja e këtij standardi dhe mospajtimi është vetëm për shkak të shpalosjes së pamjaftueshme në shënimet e PF.

Auditorët duhet të sigurojnë se çështja dhe pasoja e mundshme për raportin e auditimit, i është komunikuar personave të ngarkuar me qeverisjen. Kjo do të lejonte menaxhmentin më të lartë të diskutonte çështjen, duke iu referuar të gjitha fakteve relevante të mospajtimit. Në fund auditorët mund të zgjedhin të ngrisin çështjen në takimin e përgjithshëm vjetor, ku çështja e cila ka rezultuar me opinion me rezervë duhet të shpjegohet para aksionarëve të kompanisë.